

Studim politikash: —————>

# RINGJALLJA PËRMES KREDIVE – PRITJET DHE ARRITJET E MASËS SË DYTË TË PAKOS SË RINGJALLJES



**Autori:** Institute for Development Policy (INDEP)

**Programi:** Qeverisja Demokratike

**Publikuar:** November 2021

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në kuadër të projektit “Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri” do të monitorojë implementimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Në të njëjtën kohë, do të informojë qytetarët mbi përfitimet e kësaj pakoje, e po ashtu do të analizojë qëllimet dhe pritjet nga masat që përfshin Pako e Ringjalljes Ekonomike. Ky projekt është i mbështetur nga Balkan Trust for Democracy, një projekt i German Marshall Fund e Sh.B.A.-së dhe USAID.

# Përmbajtja

Hyrje	4
Metodologjia	6
Masa e dytë e ringjalljes	6
Zbatimi i masës së dytë	11
Përfundime	14
Rekomandime	15

# Hyrje

Pandemia COVID-19 është një sfidë sa shëndetësore aq edhe socio-ekonomike. E shfaqur në Kosovë në mars të vitit 2020, veçanërisht në kohën e izolimit të përgjithshëm, ka bërë që segmente vitale të ekonomisë të rrezikojnë shuarjen. Rritja e bruto produktit vendor në Kosovë gjatë vitit 2020 ra në 6.88%.<sup>1</sup> Duke marrë parasysh që vetëm një vit më parë, në vitin 2019, rritja e BPV-së ishte 4.9%, rënja në pothuaj 7% nën zero ishte rapide dhe shokuese për ekonominë. Ndërprerja e aktivitetit ekonomik për një numër të konsiderueshëm të bizneseve do të thoshte shuarje e plotë dhe ato që u rikuperuan, iu desh kohë që ta bënë këtë.

Vështirësitë e paraqitura dhe rreziku nga një virus i panjohur, detyruan shtetet në mbarë botën që të kufizojnë shumicën e aktiviteteve, e po ashtu për një periudhë edhe mbylljen e tyre. Shembuj të ndryshëm të qasjes ndaj luftimit të pandemisë u paraqitën, ku p.sh. Suedia nuk ndali aktivitetet ekonomike për asnjë moment, e shumë shtete tjera i stopuan ato. Në mesin e vendeve që parandalimin e përhapjes së virusit e bënë përmes mbylljeve dhe ndaljeve të aktiviteteve ekonomike, është edhe vendi ynë. E një masë e tillë shkaktoi humbje të mëdha në sektorin ekonomik, ku pasojat e dëmeve të paraqitura në atë kohë, vazhdojnë të jenë prezente edhe sot. Në mënyrë që të lehtësohen dëmet, Qeveria e Kosovës miratoi dhe implementoi pako ekonomike, të cilat në qendër të tyre kishin rimëkëmbjen ekonomike të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike - Covid-19 u miratua tek në fund të vitit 2020, ndonëse kishte filluar hartimin rreth shtatë muaj paraprakisht. Një vonesë e tillë bëri që shumë sektor të mbeteshin prapa me rimëkëmbje dhe në përgjithësi zbatimi i pakos së rimëkëmbjes të mos ishte i plotë.<sup>2</sup> Për më tepër, pakoja që ishte miratuar, kishte qenë objekt i diskutimeve dhe konflikteve të theksuara politike që shkaktuan edhe miratimin e disa amendamenteve që vendosnin incentiva shtesë për nxjerrje të qymyrit dhe mineraleve tjera. Ajo që në veçanti i mungonte pakos së rimëkëmbjes ishin kritere që do të përgatishnin një rimëkëmbje më të mirë e më të gjelbër.

Qeveria e Kosovës, tashmë ka miratuar dhe ka filluar aplikimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike.<sup>3</sup> Kjo pako ka për synim lehtësimin e dëmeve të shfaqura si rrjedhojë e pandemisë COVID-19. Kjo pako nuk është pako e parë e ndihmave që iu është ofruar qytetarëve, por është pako e katërt me rradhë. Kjo pako ka të alokuar 420 milionë euro dhe përfshin kategori mjaft të dëmtuara. Implementimi i pakos filloi pas ndryshimeve të bëra në ndarjet buxhetore dhe miratimit të pakos nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Pakoja e rimëkëmbjes, nuk ka marrë parasysh kriteret e paracaktuara për “rimëkëmbjen e gjelbër”. Nuk ka pasur as kritere të kost-reflektimit nga pandemia, efektit më të madh multiplikator në ekonomi dhe as

1 Banka Botërore (2020), BPB vjetore – Kosova, i qasshëm në

<https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.MKTP.KD.ZG?locations=XK> (qasar në tetor, 2021).

2 INDEP, (2021), Pasqyrë e zbatimit të Ligjit Nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID-19, Prishtinë: INDEP

3 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, Ministri i Financave, Punës dhe Transfere prezantoi Pakon e Ringjalljes Ekonomike prej 420 milionë Euro, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1091> , (qasar në tetor, 2021)

kritere të transformimit të sistemit energjetik dhe përmirësimit mjedisor. Këto kritere do të mund të përdoren për të rritur efektshmërinë e pakove të rimëkëmbjes por edhe për të shfrytëzuar këto momentume për të ndihmuar tranzicionin e energjisë dhe dekarbonizimin.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 16 korrik 2021, miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-016<sup>4</sup> për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021. Ndërsa me datë 28 korrik 2021, Kuvendi i Republikës së Kosovës mbajti seancën plenare, ku në rend të ditës ishte shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në po të njejtën datë, miratoi Ligjin Nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

Temë trajtimi në këtë punim do të jetë nënmasa e parë e masës së dytë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Kjo nënmasë, e titulluar “Subvencionimi i kredive investive”, ka për synim rimëkëmbjen ekonomike dhe lehtësimin e dëmeve, ku në fokus të theksuar të kësaj nënmasë janë bizneset. Për implementimin e kësaj nënmasë janë angazhuar edhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK), përmes të cilit do të garantohen fonde për një rimëkëmbje nga dëmet e pandemisë COVID-19. Ky

punim është organizuar me të dhëna të marra nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe buletinë në kuadër të projektit “Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri”.

Analiza synon që duke shtjelluar qëllimet, pritjet dhe modelin që ka paraparë masa, të nxjerrë përfundime edhe mbi kualitetin e masës si të tillë por edhe statusin e implementimit deri më tani. Mbi të gjitha, duke pasur për target audiencë politikëbërësit dhe me theks të veçantë Ministrinë e Financave dhe Zyrën e Kryeministrit, ne synojmë që përmes rekomandimeve në fund të saj, kjo analizë t'i shërbej përmirësimit të mëtejshëm të zbatimit të kësaj mase. Gjithashtu, duke shfrytëzuar mësimet e nxjerra, ne synojmë që rekomandimet të shërbejnë si bazë për dizajnimin e pakove të reja do të të jenë edhe më të zbatueshme por edhe më efektive.



<sup>4</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=36153>, (qasur në tetor, 2021)

# Metodologjia

Për hartimin e këtij punimi është përdorur metodologji e përzier, kuantitative dhe kualitative. Në pjesën ku është përdorur hulumtimi kuantitativ, INDEP përmes metodës së monitorimit dhe hulumtimit në tavolinë ka mbledhur të dhëna dhe informata rreth hapave të zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Krahas kësaj në mënyrë që ky raport të jetë sa më i plotë, INDEP ka analizuar në kontekst edhe të dhënat nga raportet dhe ekipi i analizës ka nxjerrë përfundimet.

Punimi është realizuar në kornizën e procesit të monitorimit të Pakos së Rimëkëmbjes dhe nga i cili kanë dalë edhe katër buletine dhe gjashhtë infografika të cilat synojnë të informojnë qytetarët rreth zbatimit të masave. Hartimi i punimit, por edhe i buletinëve dhe infografikave pasohet me hulumtime dhe intervista të cilat INDEP i organizon për të mbledhur të dhëna rreth Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Këto të dhëna ndihmojnë në informimin e saktë dhe në ngritjen e transparencës nga ana e institucioneve përkatëse.

Pas mbledhjes së të dhënave, përmes metodës së analizës së përmbajtjes, ne kemi analizuar edhe qëndrimet e zyrtarëve qeveritar për të identifikuar pritjet dhe impaktin që masa pritjet të ketë. Kjo, në mungesë të dokumenteve të konsultimit, memorandumeve shpjeguese dhe sqarimeve përcjellëse të cilat kryesisht mungojnë në proceset e hartimit të legjislacionit. Analiza e përmbajtjes na lejoi që të ndeshim të dhënat mbi nivelin e zbatimit me pritshmëritë që zyrtarët i kanë pasur për nënmasën në fjalë.

## Masa e dytë e ringjalljes

Bizneset janë ballafaquar me humbje të mëdha për gjatë muajve të shfaqjes së pandemisë COVID-19 dhe përhapjes së saj. Humbjet nuk kanë qenë vetëm në të hyra dhe qarkullim financiar, por edhe në humbje të fuqisë punëtore. Për shkak të vështirësive ekonomike, shumë punëtorë humbën vendet e tyre të punës, e një pjesë e tyre edhe ishin të detyruar të punonin me ulje të pagës. Prandaj pandemia si e tillë, dëmtoi rëndë jo vetëm sektorin e shëndetësisë globale, por në të njëjtën kohë, i dha një goditje të fortë ekonomisë.

Për të adresuar pasojat negative të pandemisë, COVID-19 në ekonominë e Kosovës, Qeveria e Kosovës fillimisht ka miratuar një pako emergjente, në vlerë prej 179 milionë euro. Kjo pako fokusoi ndikimin e saj në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Pastaj, Qeveria e Kosovës miratoi edhe Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike, duke ndarë 365 milionë euro për të përkrahur bizneset në krijimin dhe ruajtjen e vendeve të punës. Pako aktuale, e cila është e miratuar dhe është duke u implementuar, ka të alokuara 420 milionë euro, dhe në qendër të ndihmave ka ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha. Rritja progresive e pakove të rimëkëmbjes ka shkuar edhe paralelisht edhe me faktin që pandemia Covid-19 i rezistoi kohës dhe ishte relativisht prezente për gjatë gjithë kohës nga shfaqja e rasteve të para deri tani në fund të vitit 2021.

Një ndër nënmasat me rëndësinë më të madhe dhe me buxhetin më të lartë është nënmasa 2.1. Subvencionimi i kredive investive.<sup>5</sup>

5 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Pako e Ringjalljes Ekonomike, e qasshme në <https://mf.rks.gov.net/desk/inc/media/D3A6FA8F-6A6A-42AA-A090-52062568DC47.pdf>, (qasur në tetor, 2021)

Gjithsej të alokuara ka 30 milionë euro dhe synimi i saj është mundësia e investimeve të reja, rimëkëmbja nga dëmet e pandemisë dhe zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese. Kreditë investive lejojnë bizneset që të kenë hapësira më të mëdha për rimëkëmbje dhe plotësim të kërkesave individuale dhe kërkesave të konsumatorëve.

Kreditë investive janë financime të cilat mundësojnë hapjen e një biznesi, investim në biznesin aktual, zgjerim të biznesit, blerje të objekteve, apo edhe rinovim të biznesit. Këto kredi janë një mundësi e rivitalizimit dhe rikthimit në normalitet, për shkak se përmes tyre mund të financohen rihapje të bizneseve, rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendet e punës apo edhe hapja e një biznesi të ri. Prandaj për nga rëndësia dhe funksioni, kreditë investive janë një opsion për bizneset që synojnë rikuperimin nga pandemia.

Nënmasa 2.1. do të synojë që të ndihmojë bizneset që synojnë zgjerimin e kapaciteteve, bizneset që janë në pronësi të grave dhe bizneset të cilat nuk kanë zvogëluar numrin e punëtorëve, e të cilat në të njëjtën kohë kanë pasur dëme financiare si rezultat i pandemisë. Ndër të tjera, kjo paraqet një motivim për bizneset të cilat mund të jenë përfituese nga kjo nënmasë, pasi që përmes kredive investive mund të fillohet rimëkëmbja ekonomike. Andaj edhe bizneset do të kenë mundësinë e vendosjes së hapave të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe avansimin e zhvillimit ekonomik të tyre në rradhë të parë e më pastaj edhe të vendit tonë.

Me investimin përmes kredive, ju investoni para të huazuara dhe kjo do të thotë që mund të investoni një shumë shumë më të madhe. Për shkak se po investoni më shumë para, edhe fitimi është më i madh kur tregjet

rriten dhe paralelisht edhe humbjet janë më të larta kur tregjet bien. Nëse mund ta pranonin atë nivel të lartë rreziku, investimi me kredi mund të jetë një mënyrë efektive për të krijuar apo për të shtuar më shpejt pasurinë. Veçanërisht me subvencionimin e kryqjësë përmes masës 2.1. të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, bizneset kanë një arsyje të shtuar të përdorimit të kredive.

Subvencionimi i kredive investive mund të bëhet për të gjithë bizneset që i përkasin kategorive përfituese, e të cilat kanë marrë kredi nga data 1 tetor e tutje. Përfitimi nga kjo nënmasë, apo subvencionimi mund të jetë deri në 400,000.00 Euro. Pra për një kredi të marrë deri në vlerën 2,000,000.00 Euro, do të mund të subvencionohet 20% e saj nëse plotësohen investimet e parapara. Normalisht që bizneset mund të marrin kredi edhe më të mëdha, por kulmi i subvencionimit përmes nënmasës 2.1. është 400,000.00 Euro. Kjo masë vazhdon të jetë e hapur deri në qershor të vitit 2022.



## Cilat janë benefitet e kredive investive?

- Investimet përmes kredive investive kanë potencialin që të arrijnë targetet apo qëllimet e bizneseve për një periudhë më të shkurtër
- Një investim përmes kredive investive në shumën e përgjithshme fillon të realizohet menjëherë, në vend që të prisni të ndërtoni kursimet tuaja me një strategji tradicionale.
- Kreditë investive krijojnë kushte për një zhvillim të qëndrueshëm më të shpejtë

## Cilat janë benefitet e kredive investive?

- Investimet përmes kredive investive kanë potencialin që të arrijnë targetet apo qëllimet e bizneseve për një periudhë më të shkurtër
- Një investim përmes kredive investive në shumën e përgjithshme fillon të realizohet menjëherë, në vend që të prisni të ndërtoni kursimet tuaja me një strategji tradicionale.
- Kreditë investive krijojnë kushte për një zhvillim të qëndrueshëm më të shpejtë

Përfitues nga subvencionimi i kredive investive, apo nënmasa e parë e masës së dytë, mund të jenë disa kategori të prekurra nga pandemia COVID-19. Këto kategori përfituese janë<sup>6</sup>:

- Bizneset prodhuese dhe përpunuese që synojnë zgjerimin e kapaciteteve aktuale
- Bizneset në pronësi të grave
- Bizneset që kanë ruajtur numrin e punëtorëve, por që kanë pasur humbje financiare

Andaj, si kategori biznesore të dëmtuara nga pandemia, kreditë investive mund të paraqesin një opsion të pëlqyeshëm, për të tejkaluar dëmet dhe problemet që janë shkakuar gjatë periudhës së pandemisë.

Për bizneset prodhuese dhe përpunuese, janë disa kushte të cilat duhet të plotësohen, në mënyrë që të përfitojnë nga Subvencionimi i kredive investive. Kushti për subvencionim është<sup>7</sup>:

- Së paku 50% e investimit duhet të jetë e alokuar në pajisje për zgjerim të kapaciteteve, ndërsa pjesa tjetër mund të jetë e alokuar në shpenzime mbështetëse për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese
- Qëllimi i marrjes së kredisë duhet të jetë për zgjerim të kapaciteteve

Një kusht i tillë inkurajon këto biznese për zhvillim të mëtutjeshëm, krijim të hapësirave më të mëdha dhe rritje të kapaciteteve ekzistuese, përmes kredisë së marrë praktikisht.

6 Ministry of Finance, Labor and Transfers, Economic Recovery Package, Measure 2 - Economic and Production Recovery, Sub-measure 2.1. Subsidizing investment loans, accessible at <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/D3A6FA8F-6A6A-42AA-A090-52062568DC47.pdf> , (accessed October 2021)

7 Ministry of Finance, Labor and Transfers, Decision No. 66/2021, accessible at [https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/7095D9A9-25D7-4FB5-97AD-8EEFF4EDC1C9.pdf?fbclid=IwAR0Wr\\_w1xbCvd4z\\_fHfecDF-9k-GnITM0bIQQCC1](https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/7095D9A9-25D7-4FB5-97AD-8EEFF4EDC1C9.pdf?fbclid=IwAR0Wr_w1xbCvd4z_fHfecDF-9k-GnITM0bIQQCC1) , (accessed October 2021)



Gjithashtu për bizneset prodhuese dhe përpunuese janë disa kategori në të cilat nuk lejohet të investohen parat e kredisë. Këto mjete nuk lejohen të përdoren për blerjen e paluajtshmërive apo investimeve që nuk lidhen me veprimtarinë e prodhimit dhe përpunimit. Andaj kjo kategori biznese ka të definuara kushtet e aplikimit për subvencionim, të cilat kanë synimin e arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm dhe lehtësimin të dëmit të shkaktuar nga pandemia COVID-19, por këto mjete nuk mund t'i përdor për qëllime të cilat Qeveria e Kosovës nuk i aprovon.

Bizneset që janë në pronësi të grave janë gjithashtu kategori përfituese e nënmasës 2.1 Subvencionimi i kredive investive. Kushti për subvencionimin e këtyre bizneseve është<sup>8</sup>:

- Biznesi duhet të jetë në pronësi të grave apo të jetë shumica e biznesit në pronësi të grave
- Qëllimi i marrjes së kredisë duhet të jetë për zgjerim të kapaciteteve
- Së paku 50% e investimit duhet të jetë e alokuar në pajisje dhe mjete që ndërlidhen me veprimtarinë e biznesit

Ndërsa këto mjete nuk mund të shfrytëzohen për blerjen e paluajtshmërive apo investimeve që nuk ndërlidhen me veprimtarinë e biznesit.

Bizneset tjera do të subvencionohen deri në 10% të kredive të cilat dedikohen për likuiditet. Shuma maksimale mund të jetë deri në 30,000.00 Euro, por jo më shumë se 300.00 Euro për punëtor aktual. Bizneset përfituese mund të jenë të gjithë ato, të cilat kanë nevojë për likuiditet për të vazhduar operimin dhe për t'i mbajtur punëtorët në punë.

Aplikimi për nënmasën 2.1 Subvencionimi i kredive investive, bëhet përmes shërbimit elektronik EDI të Administratës Tatimore të Kosovës. Janë gjithsej tre faza të aplikimit të cilat janë:

- Faza e parë e aplikimit e cila bëhet për miratimin paraprak të planit investiv, qëllimit si dhe shumës së kredisë
- Faza e dytë e aplikimit e cila bëhet për subvencionimin e transhit të parë prej 15%
- Faza e tretë e aplikimit e cila bëhet për subvencionimin e transhit të dytë prej 5%

Qasja duhet të bëhet tek opsioni i shërbimeve elektronike të uebfaqes së ATK-së, ku paraqitet edhe shtojca e quajtur "Kërkesa për subvencionimin e kredisë". Të dhënat e kërkuara janë të nevojshme për të shqyrtuar se a plotësohen kushtet për subvencionim të kredisë nga ana e biznesit apo jo.

Pas procesit të aplikimit, pason edhe procesi i vlerësimit të komisionit. Komisioni duhet që të aprovojë paraprakisht këtë aplikim, dhe me arritjen e aprovimit mund të bëhet kërkesa në secilën bankë komerciale të Republikës së Kosovës për të marrë kredi. Me këtë rast edhe përmbyllet hapat e aplikimit, aprovimit dhe marrjes së kredisë nga ana e biznesit.

---

8 Ibid.

Pritjet nga kjo nënmasë janë që të ndihmohen bizneset përfituese në tejkalimin e krizës pandemike. Dëmet dhe humbjet janë të mëdha, dhe përmes kredive investive dhe subvencionimit të një pjese të tyre, nuk pritjet që të shuhet problemet. Por lehtësime dhe tejkalime të disa problemeve mund të arrihen përmes tyre. Mundësia e rritjes së kapaciteteve, kompensimeve të humbjeve dhe pagesave të papërfunduara, por edhe të tjera mund të arrihen përmes kredive.

Edhe mbështetja nga ana e Qeverisë së Kosovës, përmes kësaj nënmasë është me një prapavijë të veçantë. Kjo pasi që përmes nënmasës 2.1, Qeveria e Kosovës do të subvencionojë 15% të kryegjësë në momentin e arritjes prej 70% të investimit të planifikuar, ndërsa pjesa tjetër, pra 5%, do të subvencionohet në llogarinë bankare të biznesit, në momentin kur për shumën e njejtë janë paguar pagat e punëtorëve të rinjë që janë punësuar.<sup>9</sup> Përmes kësaj metodologjie, inkurajohen bizneset që të marrin kredi për të lehtësuar dëmet, e më pastaj edhe të përmbushin qëllimet për të cilat ato biznese kanë marrë kredi.

Objektivat e masës së dytë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike janë tërësisht të fokusuar në rimëkëmbjen ekonomike dhe rimëkëmbjen e prodhimit. Nënmasa Subvencionimi i kredive investive, lehtëson dhe shpejton arritjen e objektivit të rimëkëmbjes. Bizneset tashmë përmes kësaj nënmasë do të mund të krijojnë edhe lehtësime për arritjet në të ardhmen.

### **Objektivat e nënmasës 2.1. Subvencionimi i kredive investive:**

- **Lehtësime të dëmeve të shkaktuara nga pandemia COVID-19**
- **Krijimi i kushteve për zhvillim të qëndrueshëm**
- **Mbështetje dhe siguri për marrje të kredive**
- **Rindërtimi i ekonomisë**
- **Mundësimi i investimeve të reja**

Në Republikën e Shqipërisë, janë implementuar gjithashtu pako dhe ndihma për bizneset dhe qytetarët e dëmtuar nga pandemia COVID-19. Qeveria e Shqipërisë, përmes Garancisë Sovrane, ka implementuar dy instrumente në vlerë prej 26 miliardë Lekë apo përkthyer në Euro 213 milionë Euro<sup>10</sup> Instrumenti i Garancisë Sovrane, përmes masave të saj, subvencionon interesin e kredive dhe mundëson një grejs periudhë prej 3 muajve. Ndërsa në Garancinë Sovrane II, Qeveria e Shqipërisë ndan riskun me bankat, duke mbuluar një përqindje të principalit të cdo huaje dhe ofron grejs periudhë prej 6 muajsh.

<sup>9</sup> Ministry of Finance and Economy, Reports on COVID-19, available at <https://financa.gov.al/raporte-per-covid-19/>, (accessed October 2021)

<sup>10</sup> Ministry of Finance, Fifth package of anti-crisis measures - for recovery and development of the economy, accessible to <https://finance.gov.mk/2021/02/16/pakoja-e-pest-e-masave-anti-krize-per-ringjalljen-dhe-zhvillimin-e-ekonomise/?lang=sq>, (accessed October 2021)

Republika e Maqedonisë së Veriut, në rajon është shteti me implementimin e më së shumti pakove fiskale të cilat kanë adresuar problemet dhe dëmet e shkaktuara nga pandemia COVID-19. Gjithsej gjashtë pako janë miratuar, ku janë mbështetur kategori të ndryshme biznesore. Pakoja e pestë e masave anti-krizë, për ringjalljen dhe zhvillimin e ekonomisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ka përfshirë një masë të ngjajshme me masën e Subvencionimit të kredive investive, që e përfshin Pakoja e Ringjalljes Ekonomike të Republikës së Kosovës. Një nga shtyllat kryesore të pakos së pestë të shtetit fqinj, ka pasur synim mbështetjen financiare për likuiditetin e sektorit privat me kredi pa kamat për të mbajtur dhe rritur numrin e të punësuarve.<sup>11</sup> Pra, instrumenti apo ndihma që është përdorur atje, ka përfshirë metodologjinë e kredive pa kamatë, ndërsa tek ne bëhet subvencionimi i kryegjësë.

Një metodë e tillë, pra subvencionimi i interesit të kredisë do të kishte mundësi të aplikohet edhe përmes Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Por një masë e tillë do të përcillej edhe me kohëzgjatje të kufizuar pasi që interesi varion nga kohëzgjatja e kthimit të kredisë. Por kjo do të paraqiste probleme për bizneset pasi që do të shtohet presioni i kohës, dhe do të rritej kësti i kredisë, e në të njëjtën kohë Qeveria e Republikës së Kosovës do të kishte probleme më të mëdha sa i përket subvencionimit. Gjithashtu, rreziku mund të jetë edhe që gjatë kësaj periudhe, normat e interesit të rriten, e pastaj të paraqiten probleme me subvencionimin.

## Zbatimi i masës së dytë

Subvencionimi i kredive investive ka të ndara 30 milionë Euro. Gjatë periudhave të vështira ekonomike, kreditë për bizneset janë të një rëndësie të veçantë, pasi që krijojnë kushte për zhvillim ekonomik dhe rikthim të humbjeve. Kreditë investive mundësojnë qarkullimin e parasë, investime të ndryshme dhe forcim të stabilitetit financiar. Andaj edhe fillimi i zbatimit të kësaj nënmasë është i rëndësisë mjaft të madhe.

Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, me datë 25 gusht 2021, u miratua ndarja e 10.43 milionë Eurove për këtë nënmasë.<sup>12</sup> Kjo shumë e parave u mblodh nga letrat me vlerë, të quajtura Bonot e Diasporës. Pra kjo nënmasë ka filluar zbatimin, por ende nuk ka arritur zbatim të plotë.

Përfituesit	Përfitimet
Bizneset prodhuese dhe përpunuese	Subvencionim të kryegjësë deri në 20% (10% në fillim dhe 10% në fund të kthimit të kredisë)
Bizneset në pronësi të grave	Subvencionim deri në 20% të kryegjësë
Bizneset që kanë ruajtur numrin e punëtorëve, por që kanë pasur humbje financiare	Subvencionim deri në 10% i kryegjësë

11 Ministria e Financave, Pakoja e pestë e masave anti-krizë – për ringjalljen dhe zhvillimin e ekonomisë, e qasshme në <https://finance.gov.mk/2021/02/16/pakoja-e-pestë-e-masave-anti-krize-per-ringjalljen-dhe-zhvillimin-e-ekonomise/?lang=sq>, (qasur në tetor, 2021)

12 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, Qeveria e Kosovës ndau mbi 40 milionë euro për zbatimin e masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1115>, (qasur në tetor, 2021)


ende. Me miratimin e shumës së mbetur, i hapet rrugë subvencionimit të një numri edhe më të madhë të bizneseve që aplikojnë për këtë nënmasë. Por, me mos operacionalizimin e plotë, kjo nënmasë mbetet në zbatim të pjesshëm.

Zbatimi i masës për subvencionimin e kredive investive nuk parasheh mbështetje të veçantë për bizneset që bazohen në energji të gjelbërt. Një inkuadrim i tillë i kësaj kategori, përpos mbështetjes, do të ishte një pikë kthese apo motivi sa i përket investimeve në gjenerimin e energjisë elektrike përmes burimeve të ripërtrishme të energjisë. Një inkuadrim i një mase të tillë, do të kontribuonte në dekarbonizim dhe në ulje të ndotjes e cila shkaktohet nga prodhimi i energjisë elektrike nga burimet fosile.



## Subvencionimi i kredive investive

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nuk ka detajizuar se nga cila dritare e buxhetit apo të ardhurave tjera do të sigurohen mjetet për masën 2.1. Andaj, mungesa e transparencës apo e sqarimeve të tilla ndikon në informimin e saktë të qytetarëve. Gjithashtu nuk ka të dhëna se sa biznese kanë përfituar nga kjo nënmasë dhe se si po zhvillohet i gjithë procesi.



Shuma e alokuar

Shuma e pa alokuar

# Përfundime



- Ndonëse pandemia shkaktoi rënje drastike të bruto-prodhimit vendor dhe aktivitetit ekonomik, pakot e rimëkëmbjes krahas hapjes së ekonomisë kanë treguar efektet e tyre. Përmes pakove të kaluara dhe pakos aktuale, sektorët ekonomik po ndihmohen në mënyrë që të u lehtësohet rimëkëmbja nga dëmet që pandemia COVID-19 ka shkaktuar. Edhe pse një gjë e tillë po ndodh me hapa jo shumë të shpejtë, shenjat janë pozitive që përmes lehtësimeve dhe ndihmave, do të tejkalojnë vështirësitë e bizneseve dhe performanca e përgjithshme e ekonomisë do t'i kthehet shifrave pozitive.
- Pakoja e Ringjalljes Ekonomike ka filluar të implementohet. Shumica e masave të parapara në këtë pako kanë filluar së zbatuari. Një masë shumë e rëndësishme, e që është Subvencionimi i kredive investive, është në fazën e zbatimit të pjesshëm, pasi që vetëm 10.43 milionë Euro janë ndarë për këtë masë, nga 30 milionë Euro gjithsej. Shuma prej 10.43 milionë Euro është mbledhur nga investimet e qytetarëve në Bonot e Diasporës, ndërsa pjesa prej 19.57 milionë Euro nuk është bërë e ditur se nga cila dritare e buxhetit do të mbulohet.
- Benefitet nga nënmasa 2.1 Subvencionimi i kredive investive, mundësojnë lehtësimin e rimëkëmbjes ekonomike. Kjo pasi që ofrohet një grejs periudhë e cila mundëson investime të menjëhershme, e më vonë fillimin e kthimit të kredisë. Gjithashtu, përmes kësaj nënmase subvencionohet deri në 20% e kredisë, e cila paraqet një lehtësim mjaft të theksuar për bizneset. Ndër të tjera, kjo nënmasë ofron kushte për rritjen e kapaciteteve ekzistuese të bizneseve, duke tentuar arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm në të ardhmen.
- Kategoritë përfituese nga kjo nënmasë, janë kategori shumë të prekura dhe të dëmtuara nga pandemia COVID-19. Bizneset prodhuese dhe përpunuese që synojnë zgjerimin e kapaciteteve aktuale, bizneset në pronësi të grave dhe bizneset që kanë ruajtur numrin e punëtorëve, por që kanë pasur humbje financiare janë kategoritë që mund të aplikojnë për përfitime nga kjo nënmasë. Përpos synimit për lehtësim të dëmeve, këto ndihma paraqesin edhe një motiv të shtuar për zhvillim ekonomik të mëtutjeshëm për këto biznese, por edhe për të gjithë ekonominë qarkore, e cila lidhet me këto biznese.
- Përfitimet e nënmasës 2.1 lidhen me subvencionimin e kryegjësë së kredisë. Kryegjësja paraqet shumën totale e cila duhet t'i paguhet bankës në të cilën merret kredia. Andaj varësisht nga kategoria përfituese, subvencionimi i kryegjësë mund të jetë deri në 20%. Një pjesë e saj do të subvencionohet në fillim, saktësisht 10%, ndërsa pjesa tjetër prej 10% do të subvencionohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, nëse përmbushen objektivat e marrjes së kredisë. Pra nëse investimet e parapara, e të cilat mund të jenë zgjerim i kapaciteteve ekzistuese, krijim i kapaciteteve të reja, digjitalizim apo edhe rritje e stafit, përmbushen, atëherë subvencionohet pjesa prej 10% e kryegjësë.



## Rekomandime

- Qeveria e Kosovës duhet të monitorojë me kujdes dhe shtuar procesin e marrjes së kredive dhe shfrytëzimit të tyre. Kreditë investive duhet të përdoren për qëllime të caktuara që ndërlidhen me ringjalljen dhe përdorimi i tyre në fusha të tjera nuk duhet të subvencionohet. Gjithashtu, kjo masë, pra Subvencionimi i kredive investive duhet të monitorohet nga ana e institucioneve, në mënyrë që të sigurohet se përdorimi i tyre po bëhet ekskluzivisht për qëllimin për të cilin janë marrë.
- Për këtë pako të ndihmave, Qeveria e Kosovës nuk ka zhvilluar diskutime dhe konsultime. Nuk ka pasur konsultime publike, nuk është zhvilluar diskutim me qytetarët për të kuptuar edhe më mirë nevojat e qytetarëve dhe si rrjedhojë Pako e Ringjalljes Ekonomike do të kishte mundësi të dizajnohej ende më mirë po të konsideroheshin edhe këto elemente. Rekomandojmë që cilado pako e ardhshme e ringjalljes apo rimëkëmbjes që do të dizajnohet, të ketë në qendër konsultimin publik me palët e interesuara. Dokumentet e pakove duhet të vihen në konsultim publik dhe një mundësi duhet t'u jepet të gjitha palëve për të kontribuar.
- Monitorimi i Pakos së Ringjalljes Ekonomike do të duhej të pasohej me një uebfaqe apo mekanizëm. Përmes kësaj uebfaqe apo mekanizmi, do të rritej niveli i transparencës, do të informoheshin më shpejtë dhe më lehtë qytetarët, shoqëria civile dhe të gjithë akterët e tjerë të përfshirë në këtë proces. Gjithashtu, me aplikimin e një metode të tillë, do të mund të rritej kërkesa për llogaridhënje nga ana e Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
- Qeveria e Kosovës duhet të bëjë një kampanjë informimi më të intensifikuar rreth aplikimit dhe përfitimit nga masat e Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Nuk ka shpërndarje të duhur të informatave tek qytetarët, andaj edhe numri i aplikimeve nuk është i duhuri deri më tani. Një fushatë marketingu dhe e informatave të shtuara do të ndikonte në rritjen e aplikimeve dhe rrjedhimisht edhe të përfituesve.
- Kategoritë e bizneseve përfituese nga nënmasa 2.1. Subvencionimi i kredive investive duhet të rriten. Përpos kategorive që aktualisht janë përfituese nga kjo nënmasë, edhe bizneset tjera të cilat janë dëmtuar si shkak i pandemisë COVID-19 duhet të përfshihen në këtë mbështetje që ofrohet nga kjo nënmasë.
- Në mënyrë që rimëkëmbja të jetë e gjelbër dhe të jetë një forcë reformuese e uljes së ndotjes dhe transformimit të gjelbër të sistemeve energjetike dhe mjedisore, një veëmendje e shtuar duhet t'u kushtohet masave që kursejnë energjinë, ndryshojnë trendet e konsumit të energjisë dhe kërkesën për energji etj.



“Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Balkan Trust for Democracy, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, USAID-it apo të Qeverisë Amerikane.”